



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:094926  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05606776

**A.C.nr.3831/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Bujar Muzaqi, Kryetar, Enes Mehmeti dhe Hysni Bardheci anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit Q.T. nga fshati B..., Komuna Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson J.R., avokat me seli në Komuna Ferizaj, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, SH.A, me seli në Komuna Prishtinë, në çështjen kontestimore lidhur me kompensimin e diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, departamenti i përgjithshëm, divizioni civil, C.nr.1268/20 datë 19.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2024, mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**HEDHET** ankesa e të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, SH.A, me seli në Komuna Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, departamenti i përgjithshëm, divizioni civil, C.nr.1268/20 datë 19.04.2021, e **PASAFATËSHME**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj, departamenti i përgjithshëm, divizioni civil, me aktgjykimin C.nr.1268/20 datë 19.04.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

*“... I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Q.T. nga fshati B..., Komuna e Ferizajt, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A Prishtinë:*

a) *ANULOHEN pjesërisht kontrata e punës me numër 9353/3212 e datës 01.01.2014, përkatësisht neni 5 i saj dhe aneksë kontrata me nr.9353 të datës 01.10.2014 përkatësisht neni 1.*

b) *DETYROHET e paditura Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A Prishtinë që t'ia paguaj paditësit Q.T. nga fshati B..., Komuna e Ferizajt diferencën e pagës në shumën totale prej 3,132.00 Euro për periudhën 01.01.2014 deri më datën 21.01.2015 (dallimi 60.00 Euro, nga 360.00 Euro paga mujore, në 420.00 Euro) dhe nga data 21.01.2015 e deri në përpilimin e ekspertizës financiare me datë 22.02.2021 (dallimi 40.00 Euro, nga 390.00 Euro paga mujore, në 430.00 Euro), me kamat prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit, në kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.*

*II. DETYROHET e paditura Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A Prishtinë që t'ia paguaj paditësit Q.T. nga fshati B..., Komuna e Ferizajt shpenzimet e procedurës në shumën prej 974.00 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, në kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm...".*

Kundër këtij aktvendimi pas afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar të ndryshohet aktgjykimi dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, ose të prishet aktgjykimi dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

***-Ankesa është e paraqitur pas afatit ligjor.***

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se palëve ndërgjyqëse iu është dërguar nga një kopje e aktgjykimit C.nr.1268/20 datë 19.04.2021, dhe atë të paditurës i është dorëzuar më datë 28.04.2021, siç shihet nga fletëkthesa e Gjykatës, ndërsa ankesën pala e paditur e ka dorëzuar në Gjykatë me datë 17.05.2021, e cila vërtetohet nga zyra e pranimit në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Nga momenti i pranimit të aktgjykimit C.nr.1268/20 datë 19.04.2021, e deri në dorëzimin e ankesës në Gjykatë me datë 17.05.2021, kanë kaluar 17 ditë, ndërsa afati për paraqitjen e ankesës është 7 ditë. Si datë e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 07.05.2021, që do të thotë ankesa e palës së paditur është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor, pra është dorëzuar 9 ditë pas afatit ligjor.

Në nenin 477 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, në mënyrë decidive thuhet se : *“Afatit për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit apo kundër aktvendimit është shtatë (7) ditor.”*, andaj Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 2, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, sipas të cilit ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, si dhe bazuar në nenin 196 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ku këtë nen në mënyrë decidive thuhet se : *“ Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186”*.

Nga të lartë cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi e bazuar në nenin 195 par.1 pika a), dhe nenin 196 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.3831/2021 datë 18.04.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**